

Nëse një person bën mëkat dhe pendohet, Allahu do t'ia pranojë pendimin dhe kështu do t'ia falë. Allahu në Kur'anin e Shenjtë thotë:

"Zoti juaj ia ngjeshi vetes mëshirën. Kush bën prej jush ndonjë të keqe pa dije, e mandej pas asaj (të keqe) pendohet dhe përmirësohet, s'ka dyshim se All-llahu është që falë shumë dhe është Mëshirues".
(En'am: 54)

Allahu është Bujar dhe i Butë, Ai e shumëfishon shpërblimin për veprat e mira, ndërsa fal për veprat e këqija. Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sellem, duke i transmetuar fjalët e Allahut, ka thënë:


"Allahu ka njoftuar për veprat e mira dhe veprat e këqija, pastaj Ai i ka sqaruar ato. Kushdo që ka për qëllim të bëjë një vepër të mirë por nuk e bën, Allahu do t'ia regjistrojë (llogarit) si vepër të mirë të plotë. Nëse ai ka për qëllim ta bëjë atë dhe e bën, atëherë Allahu do t'ia regjistrojë (llogarit) ndërmjet 10 dhe 700 vepra të mira të plota. Kushdo që ka për qëllim të bëjë vepër të keqe por nuk e bën atë, Allahu do t'ia regjistrojë (llogarit) si një vepër të mirë të plotë; nëse ka për qëllim ta bëjë atë dhe e bën, atëherë Allahu do t'ia regjistrojë (llogarit) si një vepër të keqe. (Transmeton Buhariu)

www.islamonline.com

Përgatiti: Klubi Studentor

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën.

Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.



TOLERANCA E ISLAMIT



Islami është fe e mëshirës dhe mirësisë, fe e tolerancës dhe lehtësisë. Allahu nuk i ka ngarkuar muslimanët me më shumë se sa mund të mbanjnë. Çfardo të mirë që bën një musliman, do të shpërblehet për të, ndërsa çfardo të keqe që bën, do të mbajë dënimin e atij mëkati. Allahu në Kur'an thotë:

"All-llahu nuk ngarkon askë përtej mundësive të veta, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi". (Bekare: 286)

Allahu ua lehtëson muslimanëve çdo vështirësi për të gjitha gjërat që Ai i urdhëron: Allahu thotë:

"Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi". (Haxhxh: 78)

Çfardo mëkati që bën një musliman, për shkak se gabon ose harron, ose është i detyruar për ta bërë atë, ai falet nga Allahu.

"Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë!" (Bekare: 286)

Dhe Allahu thotë: lutja juaj pranohet.

Muslimani do të jep llogari për atë që e bën me vetëdije, e jo për atë që e bën me harresë. Allahu në Kur'an thotë:

"Nuk është ndonjë mëkat jauji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaj e bëjnë qëllimisht, po All-llahu është që falë, është mëshirues" (Ahzab: 5)

Allahu është i Butë dhe i Mëshirshëm. Ai e dërgoi Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, t'i ftojë njerëzit në besim në një Zot - një besim i lehtë dhe tolerant:

"All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështërsim për ju". (Bekare: 185)

Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Feja është shumë e lehtë dhe kushdo që e stër-ngarkon veten në fenë e tij nuk do të ketë mundësi të vazhdojë në atë mënyrë. Pra, ju nuk duhet të jeni ekstremistë, por duhet të mundoheni të jeni afër për-sosshmërisë dhe të pranoni lajmet se do të shpërbleheni" (Transmeton Buhariu)

Djali është armiku më i madh i njeriut. Ai e bën njeriun të harrojë kujtimin e Allahut (të bëjë dhikër) dhe ia bën mëkatin tërheqës (të bukur). Allahu thotë:

"Ata i ka nënshtruar djalli dhe ua ka qitur në harresë porositë e All-llahut. Ata janë shoqëri e djallit, e dinë se ithtarët e djallit janë më të dëshpruarit". (Muxhadele: 19)

Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë se Allahu e fal edhe atë që e thotë mendja e dikujt:

"Allahu fal Ummetin tim për mendimet që kalojnë nëpër mendjet e tyre, përderisa ata nuk flasin për to, ose nuk veprojnë sipas tyre" (Transmeton Muslimi)

Atij që bën mëkat nuk i lejohet të flet për të. Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Gjith Ummeti im do të jetë në rregull, përveç atyre që bëjnë mëkate haptazi". (Transmeton Muslimi)